

## KONKURS PUBLIK

**Pozita:** Këshilltar për Investime

**Kontrata:** Kontratë për punë dhe detyra specifike

**Kohëzgjatja:** deri në 120 ditë brenda vitit

**Pagesa:** E negociueshme

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është i përkushtuar të sigurojë stabilitetin financiar afatgjatë të pjesëmarrësve të tij duke përmirësuar vazhdimisht strategjitë e tij investuese. Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe evolucionin e shpejtë të tregjeve financiare globale, FKPK kërkon një Këshilltar të jashtëm me përvojë në Investime & Strategjinë e Investimeve, për të kryer një rishikim të plotë të strategjisë aktuale investive të FKPK-së, duke përfshirë Deklaratën e Parimeve të Investimeve (DPI) dhe alokimin strategjik të aseteve. Përveç kësaj, Këshilltari do të ofrojë mbështetje të targetuar këshilluese në të gjitha klasat e aseteve të lejuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, aksionet, të ardhurat fikse, pasuritë e paluajtshme, investimet alternative dhe ekuivalentët e parave.

### Detyrat

Këshilltari i Investimeve do të kryejë:

#### A. Rishikimin Strategjik të Investimeve

1. Kryejë një vlerësim të DPI-së të FKPK-së, me theks të veçantë në alokimin strategjik të aseteve, objektivat e investimeve dhe praktikatat e menaxhimit të rrezikut.
2. Vlerësojë portofolat aktuale të investimeve në lidhje me përputhshmërinë e tyre me grupmoshat e pjesëmarrësve (ose kritere të tjera sipas nevojës) dhe kushtet aktuale të tregut.
3. Ofrojë rekomandime për përmirësimin e strategjisë së përgjithshme të investimeve të FKPK-së, duke përfshirë rregullimet e alokimit të aseteve.

#### B. Këshillimin për investime

1. Identifikojë dhe rekomandojë mundësi specifike investimi brenda klasave të aseteve të FKPK-së, duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe profilin e rrezikut të tyre.
2. Ofrojë komente mbi propozimet e investimeve të zhvilluara brenda FKPK-së.
3. Ofrojë këshilla strategjike mbi strategjitë e menaxhimit të rrezikut në lidhje me investimet e FKPK-së.

### Dorëzimet

- Raport vlerësimi gjithëpërfshirës mbi DPI-në e FKPK-së dhe portofolat aktuale të investimeve.
- Rekomandime të detajuara dhe plan strategjik për përmirësimet e strategjisë së investimeve të FKPK-së.
- Rekomandime mujore për investime të lidhura drejtpërdrejt me portofolat e FKPK-së dhe të shoqëruara me udhëzime të qarta për menaxhimin e rrezikut.
- Komente mbi propozimet e investimeve të zhvilluara brenda FKPK-së.
- Përgatisë një raport rishikimi dhe paraqesë gjetjet dhe rekomandimet në takimet e menaxhmentit dhe Bordit të FKPK-së sipas kërkesës.

### Menaxhimi dhe Koordinimi i Detyrës

Këshilltari do të ofrojë shërbimet e tij/saj drejtpërdrejt Komisionit të Investimeve të FKPK-së (KI) dhe do të koordinohet ngushtë me Sekretariatit e Bordit dhe Bordin Menaxherial gjatë gjithë detyrës. Përditësimet dhe konsultimet e rregullta do të sigurojnë përputhjen dhe zbatimin në kohë të rekomandimeve strategjike. Pjesëmarrja në takimet e Komisionit të Investimeve dhe Bordit Menaxherial mund të kërkohej për paraqitjen e progresit dhe njohurive strategjike.

## Kualifikimet e nevojshme

- Të paktën 15 vjet përvojë në menaxhimin institucional të investimeve, me ekspertizë të konsiderueshme në fondet pensionale, aksionet dhe tregjet e të ardhurave fikse.
- Diplomë e avancuar në Financë, Ekonomi, ose fushë të ngjashme; certifikimi CFA ose CAIA i preferuar.
- Historik i dëshmuar në ofrimin e shërbimeve këshilluese për investime për investitorë institucionalë, veçanërisht fondet e pensioneve.
- Kuptim i thellë i dinamikës së investimeve si në tregjet në zhvillim ashtu edhe në ato të zhvilluara.
- Përvojë e gjerë me strategjitë e alokimit të asetëve dhe metodologjitë e menaxhimit të rrezikut.

## Kërkesa të tjera

- Njohja e rrjedhshme e gjuhës angleze, është e domosdoshme.
- Duhet të jetë i/e lirë nga çdo konflikt interesi dhe të veprojë në mënyrë të pavarur nga FKPK-ja.
- Kandidati i suksesshëm (nëse ka shtetësi të huaj) duhet të sigurojë leje për punë në Republikën e Kosovës.

## Mënyra e aplikimit

Kandidatët e interesuar dhe që i plotësojnë kushtet përkatëse, si dhe kanë përvojën e nevojshme, ftohen të dorëzojnë aplikacionin e tyre elektronik në gjuhën angleze, në formatin PDF, në adresën:

[recruitment@trusti.org](mailto:recruitment@trusti.org)

- CV-në
- Letër motivimin
- Diplomë(a), referenca/rekomandime
- Subjekti i emailit: **Emri & Mbiemri – Këshilltar për Investime**

**Aplikimet që nuk i përmbushin këto kritere, nuk do të shqyrtohen.**

**Afati i fundit për aplikim është më 17.04.2025, ora 23:59 (GMT+1).**

---